

ÇFARË REEZULTATE PËR FEMRAT QË MARRIN PJESË RREGULLISHT NË ZBULIM ?

Prej **1'000** femrave që i nënshtrohen mamografisë, çdo dy vjet, gjatë 20 vjetëve

750 femra do të kenë rezultate normale (rezultate negative)

250 femra do ta kenë një mamografi që paraqet një anomali (rezultat pozitiv). Nevojiten ekzaminime shtesë (p. sh.) Një ekografi apo biopsi

Në **185** raste, anomalia e paraqitur do të jetë beninjë

Për **65** femra, ekzaminimet do ta konfirmojnë prezencën e një kanceri.

KENI KUJDES NË GJIRET E JUAJA NË MES DY EKZAMINIVE DHE NËSE VËRENI DIÇKA JO NORMALE, KONSULTONI MJEKUN TUAJ

©FGDC 05.2022

FGDC

swiss
cancer
screening

Bd de la Cluse 43 - 1205 Genève
022 320 28 28 - secretariat@fgdc.ch
depistage-ge.ch

Avec le
soutien de



Mamografia e zbulimit

Njoftim mbi programin e zbulimit të kancerit të gjirit

www.depistage-ge.ch

PROGRAMI NË GJENEVËS

KUSH MUND TË MARRË PJESË ?

- Femrat nga mosha 50 vjeçare me vedbanim në kantonin e Gjenevës, pavarësisht shtetësisë së tyre dhe lejes së qëndrimit.
- Puntoret nga brezi kufitar nga mosha 50 vjeçare që punojnë në kantonin e Gjenevës me sigurim shëndetësor (LAMal).

SI TË MARRIM PJESË ?

- Nëse jeni në mes 50 e 74 vjeçare, çdo dy vjet, merrni një ftesë me shkrim për ta bërë një mamografi hulumtimi. Nëse nuk e keni pranuar, mund ta merrni këtë duke telefonuar në nr. e Fondacionit 022 320 28 28.
- Merrni takim pranë institutit radiologjik të autorizuar sipas zgjedhjes suaj. Lista e instituteve të autorizuar i është bashkangjitur letrës së ftesës. Me ftesën do ta merrni edhe një pyetësor shëndeti; plotësojeni, nënshkrueni (firmoseni) dhe merreni me vehte në institut ditën e ekzaminimit.

SA KUSHTON ?

- Prej moshës 50 vjeçare, mamografia e zbulimit e bërë në kuadër të programit është e rimbursueshme çdo dy vjet nga sigurimi shëndetësor pavarësisht nga franshiza e zgjedhur. Ju e paguani vetëm pjesë-marrjen prej 10%, ose rreth 20 FZ.
- Ata që përfitojnë nga ndihma e sigurimit shëndetësor mund ta kërkojnë rimbursimin (kthimin) e 10%.
- Gjithmonë është e mundur ta bëni mamografinë e hulumtimit me harxhimet tuaja. Për më shumë informata telefononi Fondacionit në nr. 022 320 28 28
- Nëse mamografia zbulon ndonjë anomali, harxhimet e bilanit plotësues kthehen (rimbursohen) nga sigurimi bazë, por me zbatimin e franshizës.

FONDATION GENEVOISE
POUR LE DÉPISTAGE
DU CANCER

CILAT JANË PËRFITIMET DHE PASOJAT E MAMOGRAFISË ZBULUESE ?

Si çdo ekzaminim mjekësor edhe mamografia ka përfitimet dhe pasojat e saja. Mungesa e anomalisë në mamografi nuk jep garanci absolute se nuk ka kancer gjiri. Kanceri mund të zhvillohet gjithashtu gjatë periudhës që ndajnë dy mamografite (kancer i intervalit).

PËRFITIMET

La mammographie permet de déceler un cancer du sein tôt dans son développement, ce qui augmente les chances de réussite du traitement.

Lorsqu'un cancer est détecté à un stade peu avancé, le traitement est généralement moins lourd : souvent, le sein peut être préservé et une chimiothérapie n'est pas nécessaire.

Cela diminue les effets secondaires pendant et après le traitement.

Le dépistage est rassurant pour la grande majorité des femmes (près de 95%) qui ont des résultats négatifs.

PASOJAT

Mamografia mund të zbulojë tumore të zhvillimit të ngadalshëm që ndoshta kurrë nuk do të kishin pasur pasoja mbi shëndetin. Meqë në momentin e diagnostifikimit ende nuk mund të themi se si do të zhvillohet kanceri, ai merret në trajtim.

Nëse zbulohet ndonjë anomali, nevojiten ekzaminime plotësuese. Në nëntë raste mbi dhjetë, nuk bëhet fjalë për kancer gjiri por për ndonjë lëndim beninjë. Pritja e rezultateve mund të jetë i mërzitshëm (stresues).

Ekspozimi në rreze X gjatë mamografisë është minimal.

Ekspertët pajtohen se përfitimet janë më të mëdha se pasojat nga doza e rrezatimit ke femrat që marrin pjesë në zbulim.

TË INFORMOHEMI PËR TË VENDOS

Një mamografi mund ta zbulojë një kancer të gjirit herët në zhvillimin e tij. Pse një gjë e tillë është e rëndësishme. Në parim, sa më herët të caktohet diagnostiku, aq më të mëdha janë shanset për shërim dhe tretmani i propozuar më i lehtë. Ju ftojmë të njoftoheni mbi dobitë dhe dëmet e hulumtimit të kancerit të gjirit përmes mamografisë. Pastaj, mund të vendosni nëse doni ta bëni këtë ekzaminim.

ÇFARË DUHET TË DIMË MBI KANCERIN E GJIRIT ?

Në Zvicër, kanceri i gjirit është kanceri më i shpeshtë ke femra. Çdo vit, ai prekë përafërsisht 5.900 femra dhe shkakton 1400 vdekje.

Frekuenca e sajë rritet me moshën : rreth 80% e rasteve janë zbuluar ke femrat e moshës mbi 50 vjeçare.

ÇFARË ËSHTË MAMOGRAFIA E ZBULIMIT ?

Mamografia është një radiografi e gjireve. Ky është një test zbulimi i këshilluar për ta zbuluar kancerin e gjirit në një fazë të hershme, para shfaqjes së simptomave dhe para se tumori të jetë i prekshëm.

ÇFARË ËSHTË PROGRAMI I ZBULIMIT TË KANCERIT TË GJIRIT ?

Programi i zbulimit të kancerit të gjirit është një veprim i shëndetit publik. Në Zvicër, dymbëdhjetë kantone tani për tani kanë pajisjet e duhura dhe u propozojnë femrave prej moshës 50 deri 69 vjeçare (50 deri 74 vjeçare sipas kantonit), ta bëjnë një mamografi zbulimi. Programet i nënshtrohen normave të rrepta të cilësisë:

- mamografite janë të vlerësuara në mënyrë të pavarur nga dy radiologë ;
- teknik-et-ët e radiologjisë dhe radiologët marrin një trajnim bazë dhe të vazhdueshëm ;
- aparatet e përdorura u nënshtrohen çdo vit një kontrolli të cilësisë ;
- Sigurimi bazë merr përsipër harxhimet e hulumtimit deri 90% - jashtë franshizës

SI BËHET NJË MAMOGRAFI ?

- Nëse i keni ende menstruacionet, caktoni takimin brenda dy javëve që vijojnë fillimin menstruacioneve tuaja, kur gjiret tuaja janë më pak të ndjeshme.
- Një mamografi zgjatë pesë deri dhjetë minuta. Duhet paraparë gjithsej një gjysmë ore për një takim.
- Ditën e mamografisë, mos përdorni losione trupore, pudrosje apo deodorante mbi gjiret gjegjësisht nën sqetulla.
- Pranoheni nga një teknike e radiologjisë. Bëhen dy radiografi të secilit gjiri. Për ta bërë një gjë të tillë, gjiri duhet të vihet në mes dy pllakave për disa sekonda që mund të jetë e pakëndshme.

KUR E MARRIM REZULTATIN ?

- Pas takimit tuaj, radiologu analizon inçizimet e juaja pastaj ia dërgon Fondacionit ku një radiolog specialist i rishikon edhe njëherë. Në rast të mospërputhjes bëhet një lexim i përbashkët (konsensual) apo një lexim i tretë.
- Rezultati iu kumtohet me shkrim brenda 8 ditësh pune. Ai i dërgohet edhe mjekut emrin e të cilit e keni cekur në pyetësorin e shëndetit.

PËR MË SHUMË INFORMATA PRANË

- mjekut tuaj
- programi juaj gjenevas
www.depistage-ge.ch - 022 320 28 28
- swiss cancer screening
www.swisscancerscreening.ch
- Lidhja gjenevase kundër kanceri
www.lgc.ch - 022 322 13 33
- Lidhja zvicerane kundër kancerit
www.liguecancer.ch - 0800 11 88 11